

AKT NORMATIV
Nr. 6, datë 30.11.2019

PËR DHURIMIN E APARTAMENTEVE FAMILJARËVE TË VIKTIMAVE, SI PASOJË E TËRMETIT TË DATËS 26.11.2019

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Dhurimin e 17 apartamenteve, në pronësi të Bashkisë Tiranë, të ndodhura në Njësinë Administrative nr. 1, Tiranë, për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhurojnë në favor të familjarëve të viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019 edhe apartamente nga fondi publik i banesave sociale, të përfituara sipas ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Neni 2

Këshilli Bashkiak Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore jep pëlqimin për tjetërsimin e këtyre pasurive të paluajtshme në favor të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas parashikimeve të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

Apartamentet që dhurohen për familjarët e viktimave, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, hiqen nga lista e pasurive të paluajtshme të Bashkisë Tiranë ose të njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

Neni 3

1. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 408, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, të ndryshuar, Bashkia Tiranë, brenda 2 (dy) ditëve pune, lëshon certifikatën e përdorimit për objektet e përcaktuara në nenin 1 të këtij akti normativ sipas gjendjes dhe dokumentacionit ekzistues të objektit.

2. Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr. 111/2018, “Për kadastrën”, përjashtimisht sipas parashikimeve të këtij akti normativ, Agjencia Shtetërore e Kadastrës kryen fillimisht regjistrimin e apartamenteve që do të dhurohen në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të Bashkisë Tiranë dhe më pas kryen veprimet e nevojshme për kalimin dhe regjistrimin e tyre në pronësi të familjarëve të viktimave të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019.

3. Dhurimi të realizohet nëpërmjet kontratës së dhurimit, sipas parashikimeve të Kodit Civil.

4. Kontrata nënshkruhet nga kryetari i Bashkisë Tiranë ose i njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe nga përfaqësuesit e familjeve përfituese, të përcaktuara në listën e dërguar nga Komiteti Ndërmintoror i Emergjencave Civile.

5. Apartamenti i dhuruar regjistrohet në bashkëpronësi të të gjithë anëtarëve të familjes përfituese.

6. Çdo shpenzim procedural, për kryerjen e transaksioneve për dhurimin e pasurisë, paguhen nga Bashkia Tiranë ose nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore.

Neni 4

Strukturat shtetërore të vendosin në dispozicion të gjitha burimet njerëzore dhe mjetet logjistike të nevojshme që nevojiten për transferimin e këtyre familjeve në banesat e reja në Tiranë. Të gjitha shpenzimet e mobilimit dhe të pajisjeve elektroshtëpiake për këto apartamente mbulohen nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Ngarkohen kryetari i Bashkisë Tiranë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe kryetarët e njësisë të vetëqeverisjes vendore, ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për zbatimin e këtij akti normativ.

Neni 6

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama